

Cilat janë arsyet që autoritetet kufitare mund të më refuzojnë hyrjen në hapësirën Shengen?



Autoritetet kufitare kanë të drejtë t'iu refuzojnë hyrjen në hapësirën Shengen në rastet kur ju:

- Refuzoni ti nënshtroheni kontrollit dhe intervistimit nga autoritetet kufitare;

- Nuk arsyetoni mjaftueshëm qëllimin e udhëtimit;
- Konsideroheni si kërcënim për rendin, sigurinë dhe shëndetin publik të shtetit në të cilën hyni;
- Keni precedentë të mëparshëm që iu pengojnë hyrjen në hapësirën Shengen.

Janë autoritetet kufitare që bazuar në Konventën e Shengenit japin vendimin përfundimtar lidhur me hyrjen ose jo në hapësirën Shengen.

A mundëson liberalizimi i vizave të drejtën për të jetuar, punuar dhe shkolluar në një nga shtetet e lartpërmendura?

Jo, liberalizimi i vizave nuk ju ofron të drejtën për të jetuar, punuar apo shkolluar në hapësirën Shengen më shumë se 90 ditë brenda një periudhe 180 ditore. Në rastet kur planifikoni të udhëtoni për punësim, jetesë apo shkollim që e tejkalojnë periudhën e përcaktuar, është e domosdoshme pajisja me vizë afatgjate të tipit "D", e cila do të konvertohet në leje qëndrimi.

Nëse vajza/djali im jeton në Itali a mundem unë të jetojë atje?

Jo, ju nuk mund të jetoni në Itali me vajzën/djalin tuaj. Vizat afatshkurtër nuk japin mundësi jetese por vetëm vizite apo qëndrimi afatshkurtër deri në 90 ditë brenda një periudhe 180 ditore.

Më ofron mundësi liberalizimi i vizave të ndjek studimet universitare/post universitare në vendet e Shengenit?

Ndjekja e studimeve universitare/ post universitare kërkon domosdoshmërisht pajisjen me vizë afatgjatë të tipit "D". Kjo për shkak të kohëzgjatjes së tyre që tejkalon periudhën 90 ditore, duke variuar nga 1 – 3 vjet. Ju keni të drejtë të merrni pjesë në seminare, konferenca, trajnime kulturore, sociale dhe shkencore madje edhe në shkolla verore nëse kohëzgjatja e këtyre aktiviteteve është maksimumi deri në 90 ditë.

Çfarë ndodh nëse unë i shkel afatet e qëndrimit të vizës afatshkurtër?

Rregullorja e Shengenit ka parashikuar një sërë sanksionesh për shtetasit të cilët nuk respektojnë afatet e qëndrimit që lejojnë vizat afatshkurtër. Këto sanksione bazohen në legjislacionet kombëtare të vendeve të Shengenit. Shkelja e afatit të qëndrimit mund të rezultojë edhe në përjashtim afatgjatë, që do të thotë ndalim i hyrjes në hapësirën Shengen për një periudhë 5 vjeçare.

Disa sugjerime për shtetasit shqiptarë:

- Udhëtoni me agjensi të besueshme udhëtimi;
- Nëse udhëtoni me automjet duhet të posedoni leje ndërkombëtare të drejtimit të automjetit si dhe siguracion ndërkombëtar;
- Kryeni sigurim shëndetësor për gjithë periudhën e udhëtimit;
- Sigurohuni për adresën e saktë dhe kontaktet (telefon, email) e personit/hotelit për ku po udhëtoni sepse mund t'iu kërkohen në pikat e kalimit kufitar si nga autoritetet kufitare shqiptare ashtu edhe nga ato të një vendi të hapësirës Shengen;
- Nëse nuk jeni të qartë mbi kushtet e udhëtimit lidhur me afatet e qëndrimit në hapësirën Shengen dhe dokumentet e nevojshme, pyesni punonjësit pranë pikave të kalimit të kufirit, të cilët do iu japin të gjithë informacionin e nevojshëm.



European Movement in Albania
Rr. Brigada VIII, Godina 1/3, Ap.8, Tiranë 1001, Albania
Tel/Fax: +355 4 2253184
www.em-al.org
info@em-al.org

TË UDHËTOSH PA VIZA!




Realizimi i ëndrrës për të udhëtuar pa viza!



Nëntor 2010


Duke filluar nga 15 Dhjetori 2010, ju nuk do të keni më nevojë të pajiseni me viza afatshkurtër të tipit "C" për të udhëtuar në hapësirën Shengen. Për të përfituar nga kjo mundësi ju duhet të pajiseni me pasaportë biometrike. Vizat afatshkurtër ofrojnë mundësi udhëtimit për arsye turistike, familjare, biznesi apo shkollimi deri në një afat 90 ditor brenda periudhës 180 ditore.

Rrjedha kronologjike e procesit



Në cilat shtete mund të udhëtojë pa vizë?


Pas heqjes së regjimit të vizave ju do të keni të drejtë të udhëtoni pa viza në këto shtete të kategorizuara në:



Shtetet në të cilat mund të udhëtohet pa vizë	<p>Vende Anëtare të BE-së dhe Shengenit: Austri, Belgjikë, Bullgari, Qipro, Republika Çeke, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Holandë, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovakia, Slloveni, Spanjë, Suedi.</p> <p>Megjithatë, edhe brenda kësaj hapësire ka përjashtime për territore të caktuara të tilla si: ishujt Faroe dhe Grenlanda (Danimarkë), Ceuta dhe Melita (Spanjë), Svalbard (Norvegji), Aruba, Curaçao, Sint Maarten dhe ishujt BES (Holandë).</p>
	<p>Vendet jo anëtare të BE-së Islandë, Norvegji dhe Zvicër.</p>
<p>Vendet Anëtare të BE-së ku NUK mund të udhëtohet pa vizë</p>	<p>Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda.</p>

Sa është kohëzgjatja e qëndrimit në një nga shtetet lartpërmendura?

Ju keni të drejtë të udhëtoni pa viza për arsye turistike, familjare, biznesi apo studimi afatshkurtër deri në një afat 90 ditor brenda një harku kohor prej 180 ditësh, që nga momenti i parë i kalimit të kufirit të zonës Shengen. Për shembull, në rast se ju hyni për herë të parë në zonën Shengen më 10 Tetor 2011 ju keni të drejtë të qëndroni brenda 10 Prillit 2012, maksimumi 90 ditë kohë qëndrimi. Një shembull i shpërndarjeve të ditëve të udhëtimit paraqitet si më poshtë:



A nënkupton liberalizimi i vizave mundësinë e hyrjes lirisht në hapësirën Shengen?

Po, liberalizimi i vizave ju jep mundësinë të hyni lirisht në hapësirën Shengen, pasi të jeni kontrolluar nga autoritetet kufitare. Kjo i jep të drejtë këtyre autoriteteve që krahas kontrollit të dokumentit të udhëtimit (pasaportës biometrike) t'iu kërkojnë:

- informacione mbi udhëtimin tuaj duke ju kërkuar t'i dëshmoni rezervimin e hotelit ose adresën e qëndrimit,
- t'i specifikoni arsyet e udhëtimit,
- mjetet financiare me të cilat do të siguronit jo vetëm jetesën gjatë qëndrimit në hapësirën Shengen, por edhe mjetet e nevojshme financiare për rikthimin në Shqipëri,
- siguracionin shëndetësor ose automobilistik.



Duke iu referuar Marrëveshjes së Ripranimit midis Shqipërisë dhe Komunitetit Europian si dhe Ligjit për Kufirin, policia kufitare dhe migracionit duhet të zbatojë detyrimet, që

rrjedhin nga konventat ndërkombëtare, marrëveshjet dy apo shumëpalëshe për shkëmbimin e të dhënave me organet homologe të vendeve të tjera.

Sipas nenit 6, pika 5 në Ligjin për Kufirit përcaktohet shprehimisht që udhëtarët do të nënshtrohen fillimisht kontrollit dhe intervistimit në pikat e kalimit kufitar nga policia shqiptare kufitare dhe migracionit. Në rastet kur policia kufitare dhe migracionit gjykon se udhëtari nuk arsyeton mjaftueshëm qëllimin e udhëtimit, ajo ka të drejtë të ndalojë që në territorin shqiptar kalimin e tij në hapësirën Shengen.